

Pjesa 1 - Shtojca 1: INFORMACIONE PËR OFERTUESIT

Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave – DEMOS

Rregullimi i parkut afër sallës së sportit “ 1 Tetori”- në qytetin e Prishtinës

Projekti DEMOS së bashku me Komunën e Prishtinës i fton të gjitha kompanitë e interesuara të paraqesin ofertat për kontratë në ofrimin e punimeve ndërtimore për zbatimin e projektit infrastrukturor në shkallë të vogël në qytetin e Prishtinës, pjesë e Skemës së Granteve të Bazuar në Performancë (SGBP). Zbatimi i këtij projekti do të financohet nga Helvetas Swiss Intercooperation në Kosovë (HSI-K) dhe do të bashkë-financohet nga Komuna e Prishtinës.

Ky dokument informon ofertuesit e mundshëm mbi kushtet sipas të cilave këto shërbime do të tenderohen.

1. Përshkrimi i kontratës

Qëllimi i përgjithshëm i Projektit DEMOS është përkrahja e Kosovës në procesin e saj të tranzicionit drejt një shteti demokratik dhe të decentralizuar, ku komunat ushtrojnë qeverisje gjithëpërfshirëse sociale dhe të ofrojnë shërbime efikase që u përgjigjen prioriteteve dhe nevojave të qytetarëve. Komponentët kryesore të projektit DEMOS janë:

- Shërbimet publike në menaxhimin e mbeturinave, hapësira publike dhe mobilitet në komunat e mbështetura që t’iu përgjigjen më mirë prioriteteve dhe nevojave të qytetarëve.
- Komunat e mbështetura nxisin procese demokratike dhe zbatojnë politika të qëndrueshme publike dhe procese të menaxhimit financiar.
- Përkrahja e projektit DEMOS në nivelin qendror kontribuon në kornizën e politikave më të favorshme për qeverisjen e decentralizuar.

Kërkesat sipas kësaj kontrate përfshijnë punimet ndërtimore për krijimin e kushteve më të favorshme për banorët në këtë pjesë të qytetit të Prishtinës.

Përshkrimi i detajuar i punimeve që kërkohet të kryhet në këtë projekt është dhënë në përshkrimin e projektit, i cili është në dispozicion për ofertuesit në Fushëveprimin e Punës (PJESA 1 – Shtojca 2 - Fushë veprimi i Punës).

2. Orari i zbatimit

Mars - Qershor 2017

3. Numri dhe përmbajtja e ofertës

Oferta duhet të përbëhet nga dokumentet në vijim:

1: Formulari për aplikim- (Zarfi A)

Ofertuesit duhet ta paraqesin Formularin për aplikim (PJESA 2 – Shtojca 1 e dosjes së tenderit), origjinal dhe të nënshkruar së bashku me tri kopje. Formulari për aplikim duhet të shoqërohet me dokumentacionin në vijim për ofertuesin (dhe për secilin anëtar të konzorciumit, nëse aplikoni si konzorcium):

- Deklaratën e nënshkruar për këtë aplikacion
- Certifikatën e regjistrimit (**me numrin fiskal dhe numrin e TVSH-së**)
- Dëshmia nga gjykata se kompania nuk është shpallur fajtor nga një gjykatë për kryerjen e aktit të mashtrimit, korrupsionit apo praktikave ekuivalente dhe nuk ka falimentuar ose nuk ka qenë i aftë për pagese gjatë 2 viteve të fundit.
- Listën e stafit profesional si dhe emërtimin e stafit profesional i cili do të jetë i angazhuar në këtë projekt. Lista të jetë e përcjellur me CV dhe diploma ndërsa fituesi potencial do të ketë obligim që ti sjellë diplomat e noterizuara të stafit profesional të angazhuar në këtë projekt.

2: Formularin e kapacitetit ekonomik dhe financiar - (Zarfi A)

Ofertuesit duhet të paraqesin Formularin e kapacitetit ekonomik dhe financiar (PJESA 2 - Shtojca 2 e dosjes së tenderit) origjinal dhe të nënshkruar, së bashku me tri kopje. Ofertuesit duhet të paraqesin:

- Qarkullimin mesatar vjetor gjatë 3 viteve të fundit. Nëse aplikoni si konzorcium, qarkullimi vjetor për 3 vitet e fundit aplikohet për konzorciumin në tërësi.
- Kopjet e pasqyrave financiare (për secilin anëtar të konzorciumit, nëse aplikoni si konzorcium), preferohet të jenë të audituara nga një auditor i certifikuar, dhe
- Dëshmia nga administrata tatimore mbi pagesën e të gjitha taksave (për secilin anëtar të konzorciumit, nëse aplikoni si konzorcium)

3: Oferta teknike - (Zarfi A)

Ofertuesit duhet të ofrojnë Ofertën teknike (PJESA 2 - Shtojca 3 e dosjes së tenderit) origjinale dhe të nënshkruar, së bashku me tri kopje. Oferta teknike duhet të përmbaj:

- strategjinë për zbatim
- përshkrimin e punës
- punësimin e anëtareve femra të stafit, personave me aftësi të kufizuara dhe anëtarëve të komuniteteve etnike
- cilësinë e propozuar të furnizimit (Ju lutemi tregoni se si kompania juaj do të siguroj cilësinë e projekteve nën prokurim. Ju lutemi tregoni nëse cilësia e ofertës suaj është më e lartë/më e ulët sesa cilësia e propozuar në paramasë dhe paralogari)
- orari i zbatimit/plani dinamik i punimeve i cili do të përmbajë shënimet për numrin e punëtorëve për periudhën e caktuar, llojin e punës të cilën do ta kryen stafi i caktuar si dhe kohëzgjatjen e çdo faze të punimeve. Ju lutemi tregoni nëse orari juaj përfshinë vetëm ditët e punës apo edhe ditët e vikendit.

4: Oferta financiare - (Zarfi B)

Ofertuesit duhet të paraqesin Ofertën financiare (PJESA 2 – Shtojca 4 e dosjes së tenderit) origjinale dhe të nënshkruar, së bashku me tri kopje. Ofertuesit duhet të propozojnë çmimet për secilin artikull të përcjellë me broshura, prospekte, certifikata të kërkuara në përshkrim teknik dhe paramasë dhe punë të përfshirë në paramasë dhe paralogari, sipas dosjes së tenderit.

Oferta financiare duhet të paraqitet në Euro.

Çmimet e ofruara nga ofertuesit sipas paramasës dhe paralogarisë duhet të paraqiten me TVSH, marrë për bazë se HSI-K është e liruar nga TVSH (për këtë lëshohet vërtetimi për lirim nga TVSH-ja, në bazë të numrit të fakturës). Është me rëndësi të theksohet se projekti do të jetë i bashkëfinancuar me komunën e Prishtinës, e cila nuk është e liruar nga TVSH, prandaj nga vlera totale e projektit, rreth 30% do të llogaritet me TVSH.

Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha taksat dhe detyrimet tjera në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës.

Orari

	DATA	KOHA - CET
Shpallja e tenderit	13-16 Janar 2017	
Vizita në terren	24 Janar 2017	10:00
Afati i fundit për informata dhe kërkesa	27 Janar 2017	17:00
Data e fundit për sqarime nga ana e HSI-K	03 Shkurt 2017	17:00
Afati i fundit për paraqitjen e ofertave ¹	15 Shkurt 2017	16:00

4. Natyra e kontratës

Kontrata e punës.

Ky prokurim është "procedurë me ftesë" sipas Direktivës Zvicerane të Departamentit Federal të Punëve të Jashtme mbi Prokurimin Publik të Shërbimeve, Mallrave dhe Ndërtimeve, 1 shtator 2013.

5. Negociatat

HSI-K rezervon të drejtën për të hyrë në negociata me të gjithë apo me një pjesë të ofertuesve të para-përzgjedhur me qëllim të ndryshimit dhe/ose kompletimit të ofertave të tyre origjinale.

Negociatat mund të jenë në lidhje me aspektet teknike, financiare, ligjore dhe aspektet tjera të ofertës/kontratës.

6. Kualifikimet

Pjesëmarrja është e hapur për të gjithë kompanit të regjistruara në Republikën e Kosovës.

Një konzorcium mund të jetë një grupim i përhershëm, ligjërish i themeluar apo një grupim që është themeluar në mënyre jo-formale për një procedurë specifike të tenderit. Të gjithë anëtarët e konzorciumit (d.m.th. udhëheqësi dhe anëtarët tjerë) janë përgjegjës ndaj HSI-K, ndërsa udhëheqësi merr përgjegjësinë kryesore.

7. Kostot për përgatitjen e ofertave

Nuk rimburohet asnjë shpenzim i bërë i ofertuesit me rastin e përgatitjes dhe paraqitjes së ofertave. Të gjitha kostot e tilla duhet të mbulohen nga ofertuesit, duke përfshirë shpenzimet e bëra gjatë negociatave dhe intervistimi i mundshëm i ekspertëve të propozuar.

8. Nën-kontraktimi

Nuk lejohet nën-kontraktimi i shërbimeve tek një person tjetër juridik.

9. Data tentative e fillimit të kontratës

Mars – Qershor 2017

10. Periudha fillestare e ekzekutimit dhe zgjatjes së mundshme të kontratës

Punimet ndërtimore duhet të kryhen gjatë periudhës Mars - Qershor 2017. Nuk parashihet zgjatja e kontratës përtej datave të cekura, përveç në rast të marrëveshjes mes dy palëve.

¹Secili aplikacioni i pranuar pas këtij afati të fundit mund të mos merret në konsideratë.

11. Kriteret e përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës

Secila ofertë do të vlerësohet në përputhje me kriteret dhe vlerësimin, siç detajohet më poshtë. Në rast të ofertave të paraqitura nga një konzorcium, këto kriteret do të zbatohen për konzorciumin në tërësi.

E gjithë procedura e vlerësimit është konfidenciale. Vendimet e Komisionit për Vlerësim merren në grup dhe mbledhjet mbahen në seancë të mbyllur. Anëtarët e Komisionit për Vlerësim janë të obliguar të mbajnë fshehtësinë. Raportet e vlerësimit dhe të dhënat e shkruara janë vetëm për përdorim zyrtar dhe nuk mund t'i komunikohen ofertuesve apo ndonjë pale tjetër përveç HSI-K.

1. Kriteret e para-përzgjedhjes

Pajtueshmëria administrative

Kërkesat	Dëshmia dokumentuese
Oferta e pranuar brenda afatit të fundit	Pranimi i ofertës nga HSI-K
Kombësia e kualifikuar e personit juridik	Certifikata e regjistrimit, me numër fiskal dhe të TVSH-së
Dëshmia nga gjykata se kompania nuk është shpallur fajtor nga një gjykatë për kryerjen e aktit të mashtrimit, korrupsionit apo praktikave ekuivalente dhe nuk ka falimentuar ose nuk ka qenë i aftë për pagese gjatë 2 viteve të fundit	Dëshmia valide e lëshuar nga autoriteti kompetent gjyqësor apo administrativ
Lista e kapaciteteve profesionale	Lista e anëtarëve të stafit duhet të përbëhet nga emrat, profesionet dhe nga përvoja e tyre me dëshmi – certifikatë apo diplomë (të përcaktohet veçanërisht menaxheri i punishtes). Si dhe të caktohet lista e stafit profesional i cili do të jetë permanent i angazhuar në këtë projekt. Nga fituesi potencial mund të kërkohen diplomat e noterizuara.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Kërkesat	Dëshmia dokumentuese
Qarkullimi i përgjithshëm i ofertuesit gjatë 3 viteve të kaluara (2016, 2015 dhe 2014) duhet të jetë e barabartë apo të tejkalojë 900,000 €	Një kopje e pasqyrave financiare, preferohet të jenë të audituara nga një auditor i certifikuar
Të gjitha taksat e paguara	Certifikata valide e administratës tatimore

Kapaciteti profesional dhe teknik

Kërkesat	Dëshmia dokumentuese
Gjatë 5 viteve të kaluara (2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016), ofertuesi të ketë realizuar së paku 3 projekte në fushat e specifikuar në seksionin 1	Lista e projekteve (të dëshmohen me pranime teknike ose/ dhe referenca për kryerjen e punimeve)
Lista e anëtarëve të propozuara femra për staf, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve etnike	Lista e anëtarëve të stafit nga këto grupe
Të ofrohen së paku 3 referenca për të shërbyer si dëshmi dokumentuese të ekspertizës profesionale të ofertuesve në fushën e specifikuar në seksionin 1	Lista e referencave

Ofertat e para-përzgjedhura do të procedohen për vlerësim të mëtejshëm.

2. Kriteret e vlerësimit të ofertave të para-përzgjedhura

Oferta teknike

Kërkesat	Dëshmia dokumentuese
Strategjia e zbatimit/ Metodologjia për punimet në terren që duhet të kryhen	Oferta teknike
Përshkrimi i punës	Oferta teknike
Cilësia e furnizimit	Përshkrimi i materialit i përcjellë me prospekte dhe certifikata për materialet e propozuara
Orari i zbatimit	Plani dinamik
Vlerësimi i pajisjeve që janë në dispozicion për zbatimin e kontratës	Lista e mjeteve dhe pajisjeve që janë në posedim të ofertuesit / të prezantohen librezat (kopjet) ose kontratat e shfrytëzimit të pajisjes së caktuar

Oferta financiare në Euro

Kërkesat	Dëshmia dokumentuese
Çmimi i njësisë me TVSH	Oferta financiare

Vlerësimi i kriterëve për vlerësim është si në vijim:

Kriteret	Pikët maksimale
Oferta teknike	60
Metodologjia	10
Cilësia - Përvoja dhe kapaciteti i kompanisë	30
Orari - Përvoja në punë të ngjashme	15
Anëtarët e stafit nga grupet: femra, persona me aftësi të kufizuara dhe grupe etnike	5
Oferta financiare	40
Çmimi për njësi	40
Gjithsej rezultati maksimal	100

Komponenti teknik dhe financiar ka një vlerë totale të mundshme prej 100 pikëve. Propozimet me rezultate prej 60-100 pikë do të konsiderohen teknikisht të pranueshme.

Në mënyrë që të kemi të kuptuarit më të mirë të punës së kërkuar në këtë proces të prokurimit, ofertuesit duhet të vizitojnë lokacionin në datën e caktuar për vizitë, e cila do të jetë më **24 Janar 2017 në orën 10:00, para sallës së 1 Tetori në Prishtinë**. Pritet që kjo vizitë në terren të shërbejë për të kuptuar më mirë fushëveprimin e punës nga ana e ofertuesve. Ofertuesit pritët të inspektojnë vendin ku do të kërkohen shërbimet, që të ndihmojë në llogaritjen më të mirë të kostos së punimeve që duhet të ndërmerren. Është parashikuar gjithashtu që vizitat në terren t'i ndihmojë ofertuesit për të kuptuar më mirë procesin e prokurimit dhe gjithashtu do të shmangë ndonjë mosmarrëveshje të mundshme në proces.

Pas vlerësimit të ofertave, HSI-K rezervon të drejtën për të hyrë në negociata me të gjithë apo një pjesë të ofertuesve të para-përzgjedhur për të ndryshuar dhe/ose kompletuar ofertat e tyre origjinale.

Kontrata do t'i jepet ofertës më të favorshme ekonomike. Oferta më e favorshme ekonomike përcaktohet duke vlerësuar cilësinë teknike ndaj çmimit në baza 60/40. HSI-K rezervon të drejtën të

kontraktot vetëm një pjesë të shërbimeve të kërkuara apo anulimin e procedurës së tenderit nëse nuk është e kënaqur me cilësinë e ofertave.

12. Formati i aplikacionit dhe detajet që duhet të paraqitem

Ofertat mund të dorëzohen në gjuhën Shqipe, Serbe apo Angleze, në adresën në vijim:

Për - Prend Krasniqi
HELVETAS Swiss Intercooperation - Kosovë
Rr. Nazim Gafurri 33, kutia postare 2
10000, Prishtinë
Republika e Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara përmes ndonjë metode tjetër mund të mos merren parasysh.

Oferta duhet të përmbajë **një** kopje origjinale, shënuar në mënyrë të qartë **'ORIGINAL'** dhe **3** kopje, secila e shënuar **'KOPJE'**.

Ofertat duhet të dorëzohen duke përdorur formularët standard të ofruar nga HSI-K, vetëm në kopje fizike. Ofertat duhet të dorëzohen duke përdorur sistemin me zarf të dyfishtë: pjesa e jashtme apo zarfi duhet të shënohet si: Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave – DEMOS, Projekti Prishtinë. Kjo duhet të përmbajë dy zarfe të ndara dhe të vulosura, njëri me shënimin **"Zarfi A"** dhe tjetri **"Zarfi B"**.

Zarfi **A** duhet të përmbajë:

Pjesa 2 Shtojca 1: Formulari për aplikim
Pjesa 2 Shtojca 2: Formulari për kapacitetin ekonomik dhe financiar
Pjesa 2 Shtojca 3: Oferta teknike

Zarfi **B** duhet të përmbajë:

Pjesa 2 Shtojca 4: Oferta financiare (paramasa dhe parallogaria)

(Kompanitë do të diskualifikohen nga vlerësimi nëse këto dy pjesë janë të vendosura në një zarf).

13. Ndryshimi apo tërheqja e aplikacioneve

Ofertuesit mund t'i tërheqin ofertat e tyre përmes një njoftimi me shkrim para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve.

HSI-K mban pronësinë e të gjitha ofertave të cilat nuk janë tërhequr. Rrjedhimisht, ofertuesit nuk kanë të drejtë në kthimin e ofertave të tyre.

14. Vlefshmëria e ofertave

Ofertuesit janë të obliguar për tenderët e tyre për 90 ditë pas afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Në raste të jashtëzakonshme, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë, HSI-K mund të kërkojë nga ofertuesit që të zgjatet periudha e vlefshmërisë për një numër të caktuar të ditëve, e cila nuk mund të kalojë 40.

15. Nënshkrimi i kontratës

Brenda 10 ditëve nga pranimi i kontratës tashmë të nënshkruar nga HSI-K, ofertuesi i përzgjedhur duhet të nënshkruaj dhe të vendos datën në kontratë. Dështimi i ofertuesit të përzgjedhur për të përmbushur këtë kërkesë mund të paraqes bazë për anulimin e vendimit për dhënie të kontratës. Në këtë rast, HSI-K mund t'ia jap tenderin ndonjë ofertuesi tjetër apo të anuloj procedurën e tenderit.

16. Klauzolat e etikës/Praktikat korruptive

Ofertuesit që japin deklarata të rrejshme mund të jenë subjekt i ndëshkimeve financiare që paraqet 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës së dhënë. Kjo normë mund të rritet deri në 20% në rast të shkeljes së përsëritur.

Çfarëdo përpjekje nga një ofertues për të marrë informacione konfidenciale, të arrij marrëveshje të paligjshme me konkurruesit ose të ndikoj tek Komisioni për Vlerësim ose tek HSI-K gjatë procesit të shqyrtimit, qartësimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, do të shpie në refuzimin e ofertës së tij dhe mund të rezultojë në dënime, siç përshkruhet më sipër.

Ofertuesit nuk duhet të ndikohen nga ndonjë konflikt interesi me ofertuesit ose palët tjera të përfshira në projekt. HSI-K rezervon të drejtën për pezullimin apo anulimin e procedurës së tenderit dhe/ose kontratës nëse zbulohen çfarëdo lloji të praktikave korruptive në çfarëdo faze të procesit të dhënies ose gjatë ekzekutimit të kontratës.

Ofertuesit do të refuzohen apo do të shkëputen kontratat nëse del se dhënia apo ekzekutimi i kontratës ka shkaktuar shpenzime të pazakonshme komerciale. Shpenzimet e tilla të pazakonshme komerciale janë komisionet që nuk janë të përmendura në kontratën kryesore apo që nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur në mënyrë të duhur që i referohet kontratës kryesore, komisionet që nuk janë të paguara në kthim për çfarëdo shërbimi aktual dhe legjitim, komisionet e transferuara tek një "parajsë tatimore" (tax haven), komisionet e paguara tek personi që duhet të paguhet i cili nuk është identifikuar në mënyrë të qartë ose komisionet që i paguhet një kompanie e cila duket si një kompani mbuluese (front company).

Kontraktuesve për të cilët konstatohet se kanë paguar shpenzime të pazakonshme komerciale që ndërlidhen me këtë projekt, varësisht nga serioziteti i fakteve të vërejtura, u shkëputet kontrata dhe/ose ndëshkohet.

HSI-K rezervon të drejtën për pezullimin ose anulimin e procedurës, atëherë kur procedura e dhënies së kontratës dëshmon të ketë qenë subjekt i gabimeve, parregullsive ose mashtrimeve të konsiderueshme. Nëse gabimet, parregullsitë ose mashtrimet e konsiderueshme zbulohen pas dhënies së kontratës, HSI-K mund të tërhiqet nga lidhja e kontratës.

17. Gjuha operationale

Komunikimet me shkrim për këtë procedurë të tenderit dhe për kontratë mund të bëhen në gjuhën Shqipe, Serbe dhe/ose Angleze.

Informacione shtesë

HSI-K rezervon të drejtën për anulimin e kësaj procedure të tenderit në çdo kohë, pa ndonjë përgjegjësi nga ana e saj.